

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)

DPS është Organi Kombëtar i Standardizimit në Shqipëri, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. DPS organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr.9870/2008 “Për Standardizimin”, të ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij dhe marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

DPS është përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e të gjitha veprimtarive të standardizimit në nivel kombëtar e ndërkombëtar dhe përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizmat europiane e ndërkombëtare të standardizimit (CEN, CENELEC, ETSI, ISO, IEC dhe ITU-T).

Një nga objektivat e saj kryesor, që rrjedh nga neni 75 i Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, është anëtarësimi me të drejta të plota në këto organizma, veçanërisht në CEN dhe në CENELEC, i cili është një proces në vazhdim dhe që kërkon plotësimin e kriterëve, që jepen të detajuara në **Guidën 20 të CEN&CENELEC “Kriteret për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC” dhe në Rregulloren e tyre të brendshme “Organizimi dhe Struktura”**.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018, DPS ka realizuar objektivat e mëposhtëm:

1. Përafrimi i legjislacionit në fushën e standardizimit me atë të BE

- U miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.382, datë 27.06.2018 Për miratimin e Rregullosës “Për Veprimtarinë e Standardizimit”, e cila transponon Rregulloren e BE nr.1025/2012 “Mbi Standardizimin Europian”.

Kjo rregullore është një nga tre aktet ligjore më të rëndësishme në fushën e standardizimit dhe një nga kriteret bazë për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC.

* CEN – Komiteti Europian për Standardizimin;
CENELEC - Komiteti Europian për Standardizimin në fushën e Elektroteknikës;
ETSI – Instituti Europian i Standardeve të Telekomunikacionit;
ISO – Organizata Ndërkombëtare e Standardeve;
IEC – Organizata Ndërkombëtare e Standardeve të Elektroteknikës;
ITU – Njësia Ndërkombëtare e Telekomunikacionit

2. Adoptimi i Standardeve

Standardet Europiane luajnë një rol të rëndësishëm për prezumimin e konformitetit të produkteve në treg dhe shkëmbimeve tregtare me vendet e BE-së, dhe për këtë qëllim DPS fokusohet më shumë në adoptimin e Standardeve Europiane. Gjatë kësaj periudhe:

- u adoptuan në total **2,604** standarde nga të cilat:
- **1,096** të publikuara nga CEN;
- **488** të publikuara nga CENELEC;
- **400** të publikuara nga ETSI;
- **470** të publikuara nga ISO;
- **150** të publikuara nga IEC.

Janë adoptuar **100%** standardet europiane të harmonizuara si Standarde Shqiptare të harmonizuara.


Në total, janë adoptuar si Standarde Shqiptare **25,395** Standarde Europiane (EN & HD përfshirë edhe amendamentet), specifikisht **3,069** standarde të ETSI, **6,620** standarde të CENELEC dhe **15,706** standarde të CEN; dhe

4984 janë standarde ndërkombëtare të ISO & IEC.

Janë në process për t'u adoptuar si Standarde Shqiptare (SSH) me përkthim të plotë 4 standarde europiane, si: SSH EN ISO 14816:2005; SSH EN ISO 9001; SSH EN ISO 17025; SSH EN ISO/IEC 14001 ose rreth 180 faqe. Përkthimi është realizuar nga specialistët e DPS-së.

Problem mbetet adoptimi i pjesës më të madhe të standardeve vetëm me përkthim të faqes së parë.

Grafiku i mëposhtëm tregon strukturën e standardeve Shqiptare sipas origjinës së tyre:



Origjina	SSH	SSH EN	SSH ISO+IEC	Totali
Standarde	2,302	25,395	4984	32,681

3. Komunikimi/Marrëdhëniet me publikun

- Të gjitha eventet e standardizimit janë publikuar *online* në www.dps.gov.al përfshirë këtu edhe takimet dhe dokumentat e miratuara nga Bordi Drejtues, rregulloret, buletinet, Katalogu i Standardeve Shqiptare, njoftime në Sekretariatit e ISO / IEC dhe CEFTA, artikuj të ndryshëm promovues, takimet me kompani private, prodhues të materialeve të ndërtimit dhe palë të interesuara, standardi më i ri i publikuar nga DPS.
- Janë publikuar rreth **16** artikuj promovues dhe rreth **60** ekstrakte të fushave për standarde me interes për biznesin dhe ekonominë, si dhe 18 njoftime/organizime/aktivitete të ndryshme nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO), Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN) dhe nga Komiteti Evropian i Elektroteknikës për Standardizimin (CENELEC).
- Numri i klikimeve është rritur ndjeshëm këtë vit krahasuar me vitet e kaluara - Në total janë marrë më shumë se **26,600 klikime** për publikimet në mediat sociale: [DPS facebook](#) [DPS Google +](#) dhe [DPS LinkedIn](#).
- Është publikuar dhe shpërndarë Katalogu i Standardeve Shqiptare 2018 në të dyja versionet me letër dhe me CD.
- Janë publikuar dhe shpërndarë **5** Buletinët Informativë të DPS dhe janë kontaktuar kompani biznesi të ndryshme, ku i është dhënë informacion

- mbi standardet, zbatimin e tyre, çertifikimin dhe mbi skarcot/humbjet gjatë procesit të prodhimit;
- Janë kryer notifikimet dhe janë dhënë të gjitha përgjigjet për pyetjet/kërkesat e ardhura brenda dhe jashtë vendit, lidhur me standardet dhe rregullat teknike me ndikim në tregti.
 - Janë shqyrtuar dhe përgatitur komentet për rreth 20 projektakte nënligjore me ndikim në tregti.

4. Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve

- Databaza e Standardeve Shqiptare siguron porosisë *online* për shitjen e Standardeve, gjë që rrit ndjeshëm përmirësimin e shërbimit ndaj biznesit dhe çdo pale tjetër të interesuar për standarde, duke shkurtuar kohën dhe kostot e tyre për blerjen e standardeve.
- Gjithashtu, Databaza e mësipërme siguron edhe leximin falas, në zyrat e DPS-së, nga çdokush që është i interesuar për të lexuar tekstin e standardit apo standardeve sipas fushës së interesit.

5. Bashkëpunimi me homologët në fushën e standardizimit

DPS organizoi një takim pune me Agjencinë Kosovare të Standardizimit (AKS) më 22.02.2018, në zyrat e DPS, mbi ndryshimet që do t'i bëhen Marrëveshjes AKS – DPS dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit në të ardhmen.

Në datat 12-13 Mars 2018, në Shkup - Maqedoni, u zhvillua Konferenca e parë Ballkanike e IT-së për Platformën e Standardizimit dhe Terminologjinë, organizuar nga Instituti i Standardizimit të Republikës së Maqedonisë (ISRM), ku morën pjesë Z. Riza Hasanaj dhe Zj. Kostanca Dedja. Pjesëmarrja ishte e rëndësishme sepse u prezantuan ndryshimet që po bëhen në databazat e ISO/IEC dhe CEN&CENELEC dhe u shkëmbyen eksperiencia dhe ide të databazave të Organeve Kombëtare të Standardizimit, përfshirë edhe databazën e DPS-së dhe gjithë funksionalitetet e saj.

Z. Riza HASANAJ dhe specialistë të DPS-së, Z. Pëllumb Metohu dhe Zj. Silvana Paçuka - Spaho, morën pjesë në seminarin e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në bashkëpunim me Institutin Gjerman të Metrologjisë, në datë 28 Mars 2018 në Tiranë, mbi Përputhshmërinë rregullatore që lehtëson Akreditimin dhe shkëmbimet tregtare.

Zoti Riza Hasanaj dhe zoti Pëllumb Metohu morën pjesë në takimin Vjetor dhe Asamblenë e 14^{të} të Përgjithshme të Komitetit Evropian të Standardizimit dhe Komitetit Evropian të Standardizimit në fushën e Elektroteknikës (CEN & CENELEC) organizuar në datat 20 - 22 Qershor 2018, në Bled të Sllovenisë, nga organi Kombëtar i Standardizimit të Sllovenisë, SIST.

Në datat 26-28 Shtator 2018, në Gjenevë - Zvicër, u zhvillua Asambleja e Përgjithshme e 41^{të} e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO), ku morën pjesë z. Riza Hasanaj dhe zj. Anita Peta. Pjesë e delegacionit tonë ishin edhe përfaqësues të AKS-Kosovë.

Në datat 10 dhe 11 Tetor 2018, në ambjentet e Hotel Tirana International, u zhvillua Seminari me temë "Mënyra për zbatimin e Eurokodeve në Ballkan". Seminari u organizua nga Qendra e Përbashkët Kërkimore (JRC) e Komisionit Evropian me mbështetjen e Veprimit për Zgjerim dhe Integrim të JRC-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit të Shqipërisë, Qendrës për Menaxhimin e CEN & CENELEC dhe Komitetit Teknik të CEN-it 250.

Në kuadër të Projektit IPA Rajonal për Ballkanin janë trajnuar dy specialistë të DPS, zj. Kostanca Dedja dhe zj. Anita Peta, për të dhënë trajnime më pas, palëve të interesuara në vend, lidhur me vendosjen e markës CE në produktet e ndërtimit (Rregullorja e BE-së 305) dhe ato elektrike (Direktiva e BE-së mbi pajisjet elektrike dhe elektronike).

Po në kuadër të Projektit IPA Rajonal për Ballkanin, në Dhjetor 2018, në DPS u organizua një vizitë vlerësuese nga Ekspertja e CEN&CENELEC, mbi mënyrën e organizimit të standardizimit në vend dhe shërbimet që DPS ofron për industrinë dhe ekonominë, në zbatim të Rregullores (BE) 1025/2012 "Për Standardizimin Evropian". Gjetjet dhe nevojat për përmirësim do të jenë baza për të kërkuar asistencë teknike e financiare nga CEN&CENELEC dhe nga Komisioni Evropian në këtë fushë.

6. Shitja e Standardeve Shqiptare

Një nga treguesit e rritjes së ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë, mbi rolin dhe rëndësinë e përdorimit/zbatimit të standardeve në produktet, shërbimet, kontrollet e kryera (nga mbikqyrja e tregut) apo kryerja e analizave nga laboratorët

e ndryshëm, është edhe numri në rritje i kërkesave për blerjen e standardeve Shqiptare, të cilat janë të njëjta me ato europiane e ndërkombëtare në fuqi.

Për këtë vit:

- Janë shitur gjithsej **552** standarde ose **35% më shumë** nga planifikimi, nga të cilat rreth **400** janë standarde europiane.

7. Rritja e pjesëmarrjes në Komitetet Teknike

- 15 anëtarë të rinj kanë kërkuar të marrin pjesë në Komitetet Teknike të DPS, që mbulojnë fushat:
 - Teknologji Informacioni;
 - Pajisje elektrike dhe elektronike;
 - Energjetika;
 - Infrastrukturë;
 - Ndërtim dhe materiale ndërtimi.